

HEART

ZHVILLIMI I TË DREJTATVE TË NJERIUT NË QENDËR TË ARSIMIT TË LARTË

PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE PËR

PRAKTIKAT MË MIRA NË EDUKIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT

HYRJE

Në qendër të këtij projekti që në zanafillën e tij ka qenë angazhimi për të vendosur parime për të përgjithësuar praktikat më të mira në edukimin për të drejtat e njeriut dhe për t'i përdorur ato në kontekste të ndryshme vendore. Kjo nuk është detyrë e lehtë, dhe aq më tepër duke patur parasysh natyrën problematike që ka në vetevete koncepti "praktikë më e mirë". Në një koment të kohëve të fundit për atë sesi universitetet gjithnjë e më shumë janë duke u shndërruar në organizata të cilat po i vënë theksin punësimit dhe transmetimit të aftësive që orientohen drejt tregut, autorët shprehen:

Procedurat rregullatore të paraqitura nën termin "sigurim i cilësisë" dhe proceset e standardizuara të mësimdhënies dhe të të nxëniet të cilësuara si 'praktika më e mirë' e meritojnë pyetjen që Habermasi nënkupton në shpjegimin e tij për kolonizimin e botës së jetës: më e mirë *për kë?* Si 'matet' 'cilësia' që po garantohet? Vetë ndërtimi i kriterëve të centralizuara dhe 'objektive' të çon drejt 'kafazit të hekurt' Veberian¹.

Ndonëse vendosja e udhëzimeve shumë të centralizuara të quajtuara 'praktikat më të mira' nuk është gjithmonë e mirëpritur, për një sërë arsyesh, në një fushë ndërdisiplinore dhe në zhvillim si ajo e edukimit për të drejtat e njeriut, krijimi i një grupi rekomandimesh kryesore dhe jo aq të rrepta në fakt mund të shërbejë për ata që dëshirojnë të ndjekin shembullin e të tjerëve dhe që dëshirojnë të krijojnë kurse për të Drejtat e Njeriut. Ato mund të shërbejnë jo si kriterë të standardizuara që përdoren në për të matur 'suksesin', por si standarde minimale prej të cilave njerëzit mund të frymëzohen. Pra, për t'iu përgjigjur pyetjes së paraqitur në citimin e mësipërm – praktikë më e mirë *për kë?* - fokusi këtu përqendrohet në praktikat më të mira për promovimin dhe zhvillimin e *edukimit për të drejtat e njeriut*. Në praktikë, kjo

¹ Bond, C. and O'Byrne, D. (2013) 'If It Moves, Measure It: Taylor's Impact on UK Higher Education' in C. Evans and L. Holmes (eds) *Re-Tayloring Management* Basingstoke: Palgrave



mund ose nuk mund të përfshijë ose të përkohë me atë që quhet si praktikë më e mirë për një sërë palësh të interesuara, si studentët, universitetet, punëdhënësit potencialë, OJQ-të, dhe madje edhe elitat dhe qeveritë, pa përmendur praktikën më të mirë *për promovimin e të drejtave të njeriut në një kuptim më të gjerë*.

Për të lehtësuar këtë kërkim për standarde minimale, në takimin inauguroes të projektit, partnerëve iu kërkua që të mbanin parasysh tri pyetje bazë: Çfarë kuptojmë me *edukimin për të drejtat e njeriut?*; Çfarë kuptojmë me *të drejtat e njeriut?*; Çfarë lloj *pedagogjie* mund të përfshijë edukimi për të drejtat e njeriut? Këto pyetje i referohen respektivisht praktikës më të mirë në çështjet e *kurrikulës, përmbajtjes dhe mësimdhënies*.

Duke kërkuar përgjigjet për secilën nga këto pyetje, partnerët u përballën me një sërë sfidash të tjera. Për shembull, kur ballafaqohesh me kuptimin e edukimit për të drejtat e njeriut, duhen marrë parasysh si mundësitë edhe sfidat që sjell *natyra ndërdisiplinore* e tij. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh nëse praktika më e mirë arrihet përmes krijimit të *programeve të veçanta për të drejtat e njeriut* apo përmes promovimit të një sërë *vlerash* që duhen ngulitur nëpërmjet gjithë programin mësimor.

Arritja e një marrëveshjeje për kuptimin e të drejtave të njeriut është edhe më problematike. A i referohet termi gjuhës së *lirisë? Barazisë? Drejtësisë? Respektit?* Apo diçkaje tjetër? A rrjedh gjuha nga standardet globale apo universale, apo duhet të përmbushë përparësi specifike të rajonit? A duhet vendosur theksi në sferën publike të shtetit, apo mund të përfshihen edhe aktorët joshitetërorë dhe privatë? A është dinamika e saj themelore e lidhur me marrëdhëniet shtet - qytetar, apo lidhet me marrëdhëniet shoqërore në përgjithësi? Me fjalë të tjera, cilat *janë* këto të drejta të njeriut që ne dëshirojmë t'i edukojmë te të tjerët?

Edhe në qoftë se ne jemi në gjendje të biem dakord mbi këto pyetje gjerësisht filozofike, nuk ka asnjë garanci që ekziston një konsensus për mënyrën më të mirë për të *ofruar* këtë edukim për të drejtat e njeriut, apo për të ngulitur këto vlera brenda dhe jashtë programit mësimor. Është shkruar shumë për përdorimin e emocioneve në arsim dhe në rastin e edukimit për të drejtat e njeriut kjo është shumë domethënëse. Si mund të sillen *përvojat personale* në mësimin e të drejtave të njeriut? Dhe çfarë roli, nëse ka një të tillë, duhet të luajnë në procesin arsimor organizatat e shoqërisë civile siç janë OJQ-të për drejtat e të njeriut?

Këto janë pyetjet që kanë patur ndër mend partnerët tanë kur janë pyetur për mënyrën sesi ofrohet *aktualisht* arsimi për të drejtat e njeriut në institucionet tona, dhe se ku duam të shkojmë tani, pra ç'loj arsimi për të drejtat e njeriut duam të zhvillojmë. Për të lehtësuar këtë diskutim, partnerëve iu kërkua që të përpiqeshin të gjenin dhe të adresonin çështje të praktikës aktuale dhe të ardhshme duke mbajtur parasysh këto shtatë pika kryesore:

- (1) Përmbajtja
- (2) Natyra ndërdisiplinore
- (3) Përfshirja e studentëve
- (4) Punësimi dhe aftësitë



- (5) Vlerësimi
- (6) Burimet
- (7) Përvoja e trashëgueshme

Ky raport do të përmbledhë pikat kryesore të përgjigjeve të ndryshme për këto pyetje, duke u bazuar në shembuj të praktikës së tanishme të mësimdhënies dhe të të nxëniet në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të vlerësimit të disa pengesave për arritjen e praktikës më të mirë në secilën nga këto shtatë fusha. Përveç këtyre shtatë fushave të përmendura, do të diskutohen dy fusha të tjera që ndikojnë mësimdhënien e të drejtave të njeriut, të cilat janë: çështja e partneriteteve të jashtme, veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile, si dhe çështja e marrëdhënieve ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit, pasi që të dyja janë paraqitur në raporte.

PËRMBAJTJA

Një nga pyetjet sfiduese që ne si edukatorë të të drejtave të njeriut duhet të ngremë, ka të bëjë pikërisht me përmbajtjen që duhet të ketë një program (ose modul) për të drejtat e njeriut, jashtë asaj që diktohet nga disiplina në të cilën bën pjesë moduli. Ose, për ta thënë me fjalë më të thejështa: çfarë do të *thotë 'të drejtat e njeriut'*? A i referohet termi një konteksti të caktuar ligjor (për shembull, konventave të Bashkimit Evropian)? Nëse është kështu, a ekziston rreziku që në këtë kontekst këto të drejta të përceptohen si një imponim, një kërkesë nga lart të cilave shtetet duhet t'u përmbahen, por që shpesh nuk përputhen me përparësitë vendore? Në mënyrë alternative, ato mund t'i referohen një grupi të veçantë vlerash, apo parimesh themelore të cilat ne duhet t'i ndjekim gjatë jetës sonë pa marrë parasysh se çfarë thotë ligji. Përsëri ekziston rreziku që një kontekst i tillë tepër i lidhur me aktorë të jashtëm të cilët imponojnë mënyrën e tyre të jetesës mbi të tjerët: në veçanti, mbrojtja e vlerave perëndimore të tilla si individualizmi dhe liria nga shteti të cilat nuk reflektojnë domosdoshmërisht shqetësimet vendore. Një mundësi e tretë është se ajo i referohet një gjuhe që përdoret në arenën e politikës ndërkombëtare, të cilën e përdorin një shumëllojshmëri aktorësh (shpesh duke konkurruar) për të çuar më tej qëllimet e tyre. Në një kuptim të katërt, ky term përdoret për të shprehur një shqetësim të përgjithshëm me qëllim përmirësimin e kushteve njerëzore, fuqizimin e njerëzve në nivel vendor dhe ndërtimin e 'shoqërisë së mirë'. Një kornizë e tillë sociologjike (në dallim nga korniza ligjore, filozofike ose politike) nuk ka nevojë të jetë sinonim me një projekt të veçantë apo ideologji, dhe mund, në të vërtetë duhet, të jetë një pasqyrim i nevojave vendore. Në këtë drejtim, termi 'të drejtat e njeriut' ofron *gjuhën* e cila mund të shfrytëzohet për të vënë në dukje shqetësimet vendore dhe nëpërmjet së cilës mund të lokalizohen këto shqetësime. Megjithatë, edhe një herë, ky përkufizim mund të bëhet lehtë pre e normativitetit të tepruar: shumë studentë, për shembull, dhe veçanërisht në kontekstin bashkëkohor global (periudha pas 11 shtatorit, 'lufta kundër terrorizmit', legjislacioni anti - terror, kriza ekonomike dhe deficit demokratik) i shohin të drejtat e njeriut si një mjet kundër elitave, qeverive apo korporatave të babëzitura e kështu me radhë.

Kjo çështje është diskutuar në faqet e revistave akademike shumë të respektuara, por ajo ngre një problem të veçantë në lidhje me gjetjen e praktikës më të mirë në *edukimin* për të drejtat e njeriut. Në qoftë se termi 'të drejtat e njeriut' është aq i paqartë saqë mbart një sërë kuptimesh të ndryshme, në



varësi të faktit nëse ky term përdoret nga një jurist ose një filozof, një politikan perëndimor ose një aktivist jo-perëndimor etj, dhe mbart një ngarkesë të tillë ideologjike që shpesh frymëzon përgjigjet pasionante të një negativiteti jokritik apo pozitiviteti, atëherë çfarë të bëjnë *studentët* tanë kur ta shohin atë në listën e lëndëve me zgjedhje? Me çfarë diskursi e lidhin *ata* në mënyrë që të ndikojë pritshmëritë e tyre për përmbajtjen e kësaj lëndei? Dhe a përputhen pritshmëritë e studentëve me qëllimin që ka përcaktuar pedagogu për lëndën e të drejtave të njeriut?

Një hulumtim informal i bazuar në fokus grupe për këtë çështje (detajet e të cilit janë diskutuar diku tjetër në përmbledhjet e projektit) çuditërisht tregon një mbivendosje të asaj që pedagogët dhe studentët kuptojnë me termin 'të drejtat e njeriut'. Megjithatë, ka pasur edhe disa vëzhgime interesante, të tilla si: një grup pedagogësh raportoi se studentët më së shumti i lidhnin të drejtat e njeriut me ligjin dhe me OJQ-të, me një lëndë tepër të rëndësishme për studentët e fakultetit të drejtësisë. Ndërsa studentët nga ana tjetër raportonin se ndërsa perceptimet e pedagogëve zakonisht shtriheshin ndërmjet përkufizimeve ligjore dhe filozofike, ata ishin më të prirur që ta përdornin këtë term në këndvështrim filozofik ose në atë sociologjik.

Asgjë nuk mund të përgjithësohet në *vetvete* nga këto reagime, por pyetjet të cilat i nxitën këto reagime duhet të informojnë kërkimin tonë për praktikën më të mirë në edukimin për të drejtat e njeriut. Me fjalë të tjera, kur përmendim termat si të drejtat e njeriut në klasë, qoftë në titullin e një moduli ose thjesht si pjesë e përmbajtjes së tij, ne duhet të sjellim ndër mend faktin se studentët do ta lexojnë dhe kuptojnë atë term në mënyra të ndryshme, madje edhe në kundërthënie, jo domosdoshmërisht të paraqitura nga pedagogu (p.sh imponimet perëndimore që mohojnë fuqizimin vendor kundër strategjive nga poshtë-lart për fuqizimin vendor).

Në Universitetin e Roehamptonit, pohimi se të drejtat e njeriut përbën një temë të hapur dhe jo të mbyllur: *në teori*, çdo gjë mund të bëhet një çështje e të drejtave të njeriut, por ajo duhet të paraqitet si e tillë përmes zbatimit të *një qasjeje të bazuar te të drejtat e njeriut*, është përforcuar gjatë gjithë programit Bachelor për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht në lëndën e vitit të parë 'Çështje Bashkëkohore në të Drejtat e Njeriut' dhe në lëndën e vitit të dytë 'Sociologji dhe Antropologji e të Drejtave të Njeriut'. Kjo do t'u japë mundësi studentëve që të ngrenë diskutime me përmbajtje të ndryshme në klasë, qoftë në formën e një prezantimi për një temë që lidhet me të drejtat e njeriut në vitin e parë, ose me anë të 'dosjes së një projekti për një fushatë' në vitin e dytë, pasi fokusi i lëndës së të drejtave të njeriut nuk do për caktohet nga përmbajtja, por nga mënyra sesi studentët i konceptojnë diskutimet për të drejta e njeriut'.

Kjo qasje ka problemet dhe kufizimet e veta: i duhet kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të pushtetit dhe zbulimit të interesave, dhe vetë studentët duhet të ushtrohen gjatë procesit të reflektimit që reflektojnë se cilin qëndrim duhet të mbajnë kur e 'bëjnë' diçka një çështje të të drejtave të njeriut. Megjithatë, një element i praktikës së mirë që mund të merrt nga këto diskutime është që të paktën të mos përdoret një gjuhë e zakonshme kur mbahet një leksion për të drejtat e njeriut. Do të ishte e dobishme që në fillim që të nixtej diskutimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve përsa i përket pritshmërive që ata kanë për përmbajtjen e lëndës, dhe kjo mund të sjellë më tej ndryshime në kurrikul



ku mund të përfshihen fusha që ngjallin interes të veçantë për studentët. Një seancë e tillë mund të mos vendoset 'në rendin e ditës' në klasë, por shumë mirë mund të ndihmojë për të larguar çdo lloj keqinterpretimi.

Natyrisht, një dialog i tillë është i dobishëm të kryhet jo vetëm ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, por edhe ndërmjet studentëve me njëri-tjetrin, si dhe ndërmjet pedagogëve. Universiteti i Zenicës na jep një shembull të mirë sesi ta trajtojmë përshtjellimin e mundshëm që mbart termi 'të drejtat e njeriut' tek studentët. Në këtë universitet organizohen debate specifike për të qartësuar se çfarë duhet të kuptojnë pjesëmarrësit me termin 'të drejtat e njeriut'.

Debatet e këtij lloji mund të jenë të dobishme si për pedagogët, edhe studentët, edhe pse dikush mund të dyshojë se ato mund të mos priten mirë dhe se mund të hasin në disa vështirësi praktike. Megjithatë, problemi i arritjes së një konsensusi në radhët e personelit akademik është vendimtar për të tërë projektin, sidomos ku ka më shumë se një lëndë që lidhet me të drejtat e njeriut, në mënyrë që të sigurohet që studentët të mos marrin 'mesazhe të paqarta' nga anëtarë të fakultetit të cilët janë vetë subjekt i të njëjtave probleme kur vjen puna për të përcaktuar kuptimin e termit 'të drejtat e njeriut'. Ky është një problem i veçantë i fushave ndërdisiplinore, ku, për shembull, do të ishte e pazakontë që një pedagog i ligjit për të drejtat e njeriut t'u paraqiste studentëve një përkufizim krejtësisht ligjor të termit 'të drejtat e njeriut', ndërsa një pedagog i filozofisë të së drejtave të njeriut t'i paraqiste një përkufizim shumë larg atij normativ.

Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë pengesë për studimet ndërdisiplinore, në qoftë se ne marrim në shqyrtim tre shembuj: lëndën 'Të Drejtat e Njeriut' e ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin Europian të Tiranës, lëndën e 'Filozofisë së të Drejtave të Njeriut' të ofruar në programin MA në filozofi në Universitetin e Prishtinës, dhe lëndën 'Kultura e të Drejtave të Njeriut' e ofruar nga Fakulteti i Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit. E para është "konceptuar si një kurs ndërdisiplinor dhe gjithëpërfshirës që ka të bëjë me të drejtat ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të grupeve të ndryshme" i cili "është i lidhur ngushtë me disiplina të tjera të shkencave sociale, ekonomisë, komunikimit dhe arsimit" pavarësisht faktit se është një modul i cili, në thelbin e vet, "kërkon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike për të drejtat e njeriut nëpërmjet studimit të *instrumenteve kryesore ligjore dhe thuajse ligjore të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare*" dhe në veçanti "për çështjet e ndërlikuara në sistemin ligjor në Shqipëri: të tilla si e drejta e pronës, liria individuale, e drejta e ankimit etj". Është mëse e qartë se ky është një kurs që i përket fushës së drejtësisë. Lënda e dytë "trajton teorinë e të drejtave të njeriut dhe diskuton pikëpamjet dhe interesat e shumë filozofëve të mendimit klasik liberal: John Lokut, Monteskje, Tomas Peinit, Emanuel Kantit dhe Xhon Stjuart Millit ... Riçard Rortit, Alan Geruirthit, Brajan Berit dhe Ronald Duorkinit". Kjo bëhet nëpërmjet angazhimit në debate kyçe (p.sh. të drejtat e njeriut si të drejta natyrore, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe inventari më i gjerë i të drejtave; të drejtat negative dhe pozitive, universalizmi kundrejt relativizmit kulturor). Lënda e tretë ndahet në tre nënseksione: Pjesa I merret me teori që lidhen me justifikim, përmbajtjen dhe konfrontimin ndërmjet të drejtave të ndryshme të njeriut, Pjesa II prezanton aspektet ligjore të të drejtave të njeriut dhe mekanizmat në dispozicion për mbrojtjen e tyre; Pjesa III kërkon nga studentët që të vlerësojnë



ndërveprimet dhe ndërvarësitë ndërmjet të drejtave të njeriut, kulturës dhe politikave. Këto lëndë kanë një konceptim klasik në shumë aspekte dhe studentët në mënyrë të logjikshme do të presin që përmbajtja e këtyre lëndëve për të drejtat e njeriut të shihet respektivisht në aspektin e së Drejtës, Filozofisë dhe të Shkencave Politike. Megjithatë, mundësia e mbivendosjes dhe lidhjes ndërmjet disiplinave të ndryshme është e qartë (ndoshta veçanërisht kjo vihet re në lëndën që jepet në Beograd e cila nuk është gjë tjetër veçse një modul ndërdisiplinor). Ajo ç'ka i bashkon këto tri qasje të ndryshme të studimit të të drejtave të njeriut (dhe çka i mungon shumë lëndëve të ngjashme, por që studentët në fokus grupet e përmendura më lart i kanë identifikuar si të domosdoshme) është një bazë më e fortë teorike. *Teoria*, këtu, nuk është sinonim me *filozofinë*. Filozofia e të drejtave të njeriut nuk siguron bazën teorike për lëndën e të drejtave të njeriut të ofruar në fakultetin e drejtësisë. Teoria e të drejtave të njeriut, e cila merret me çështjen më të përgjithshme sesi dhe ku përdoret termi 'të drejtat e njeriut' dhe çfarë kuptohet me këtë term, i përfshin të dyja, filozofinë dhe teorinë, dhe duhet paraqitur ashtu siç vuri në dukje raporti i Universitetit të Sarajevës, pra në perspektivë historike në mënyrë që të mund të shihet nga pedagogët dhe studentët si një mënyrë e *disiplinave transendente*². Kjo, pastaj, na çon qartë drejt temës së lidhjes ndërmjet disiplinave.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Bëni kujdes në përdorimet dhe interpretimet e shumta të termit 'të drejtat e njeriut' dhe përpiquni të largoni çdo keqinterpretim duke u marrë me këtë problem që në fillim, dhe në një mënyrë të tillë që ju mundëson të punoni me këto përkufizime që përbëjnë një sfidë sesa të dilni kundër këtyre përkufizimeve konkurruese. Kjo vlen si për pedagogët ashtu edhe për studentët. Edhe kur punoni në një fushë më të konsoliduar, si për shembull në lëndën e ligjit për të drejtat e njeriut, mos harroni se një përkufizim ligjor është vetëm një prej përkufizimeve dhe se studentët do hasin përkufizime të tjera më pak (ose më shumë) të ligjshme. Kjo nuk ju kërkon juve (p.sh. lektori i së drejtës) të ndryshoni përkufizimin e tuaj (sepse përkufizimi juaj pasqyron haptazi përmbajtjen e lëndës suaj), thjesht ai duhet të pranojë se nuk është një përkufizim absolut kur i referohemi debateve më të gjera për të drejtat e njeriut (p.sh. atyre ligjore dhe joligjore). Një mënyrë për ta bërë këtë është duke e përfshirë më shumë në diskutime teorinë themelore të të drejtave të njeriut, e cila nuk është e ngjashme me filozofinë e të drejtave të njeriut. Ndërkohë, në mënyrë që edhe studentët të kuptojnë se çfarë duhet të presin nga lënda e të drejtave të njeriut, mund të jetë e dobishme që studentët të angazhohen në debate për domethënien që ka ky term për ta.

NATYRA NDËRDISIPLINORE

Në qoftë se ne pranojmë se mësimi i të drejtave të njeriut duhet të shtrihet përtej kufijve të thjeshtë dhe të ngushtë disiplinore, si mund ta arrijmë këtë në mënyrë që të jetë e kuptueshme dhe të ketë rëndësi

²Nuk është e mundur që në këtë dokument të përshkruhet në mënyrë më të zgjeruar se çfarë e përbën *teorinë* e të drejtave të njeriut (dhe se si kjo ndryshon nga *filozofia* e të drejtave të njeriut). Për ilustrim, në vijim do të gjeni referenca që lidhen me teorinë e të drejtave të njeriut: Dunne, T. and Wheeler, N. J. (1999) 'Introduction: Human Rights and the Fifty Years' Crisis' in T. Dunne and N. J. Wheeler (eds) *Human Rights in Global Politics* Cambridge: Cambridge University Press; O'Byrne, D. (2012) 'Re-Imagining the Theory of Human Rights' in *International Journal of Human Rights* 16, 7, 1078-1093.



për studentët duke mos e vënë në rrezik natyrën disiplinore të modulit në fjalë? Sugjerimi i bërë më lart, pra përfshirja e *teorisë* së të drejtave të njeriut për të kontekstualizuar përmbajtjen specifike të disiplinës, i përshtatet qartë të gjitha programeve për të drejtat e njeriut, ku module të tëra mund të zhvillohen për këtë qëllim i cili mund të shërbejnë si parakusht më vonë për lëndë të bazuara në disiplinë. Kjo ishte filozofia ku mbështetet programin BA për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Roehamptonit, ku, në vitin e parë, studentët njihen me idetë kryesore të përgjithshme në diskursin e të drejtave të njeriut dhe nxiten që të përqëndrohen në artikullimin e qasjeve të bazuara te të drejtat e njeriut përpara se të kalojnë në vitin e dytë që i kushtohet moduleve të bazuar në disiplinën e të drejtave të njeriut në kontekstin ligjor, në filozofinë e të drejtave të njeriut, në qasjen politike e ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe në punën sociologjike dhe antropologjike në këtë fushë. Megjithatë, kur nuk ekziston një lëndë e tillë gjithpërfshirëse, është e vështirë që të gjendet hapësirë për lëndë bazë dhe paraprirëse. Atëherë, si mundet që natyra ndërdisiplinore e të drejtave të njeriut t'u prezantohet në një mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe pa marrë shumë kohë studentëve, që ndjekin lëndën e të drejtave të njeriut në programin e drejtësisë ose të filozofisë së të drejtave të njeriut në kuadrin e programit të filozofisë dhe kështu me radhë?

Shumë nga institucionet partnere aktualisht ofrojnë module të cilat kanë të bëjnë me temat kyçe të të drejtave të njeriut në një sërë programesh dhe departamentesh. Për shembull, Universiteti i Prishtinës ofron lëndë të posaçme ose të përafërta në departamentet ose fakultetet e Shkencave Politike, Sociologjisë, Antropologjisë, Psikologjisë dhe Filozofisë. Disa prej tyre kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për studimin e të drejtave të njeriut - p.sh. lënda e vitit të parë 'Të Drejtat e Njeriut, Barazia dhe të Drejtat e Minoriteteve' lidhet me Shkencat Politike, lënda e propozuar e vitit të tretë 'Sociologjia e të Drejtave të Njeriut' lidhet me programin e rivlerësuar të Sociologjisë, një modul i MA 'Filozofia e të Drejtave të Njeriut' lidhet me Filozofinë. Ndërsa lëndë të tjera mbulojnë çështje të rëndësishme në këtë fushë, të tilla si gjinia, jeta urbane, çështjet evropiane, politika, feja ose kultura. Temat janë të përfshira edhe në lëndët e metodave të kërkimit në disa departamente. Të tilla arritje janë bërë edhe në Universitetin e Zenicës, ku çështjet e të drejtave të njeriut përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në programe të ndryshme si Ekonomi, Gjuhë angleze, gjermane, turke, Studime Kulturore, dhe, në mënyrë të dukshme, në lëndët e programit të mësuesisë duke përfshirë edhe arsimin parashkollor.

Në disa institucione partnere, u vendos që të krijoheshin grupe pune ndërkurrikulare dhe që përfshinin disa departamente për të ndihmuar integrimin e mëtejshëm të çështjeve të të drejtave të njeriut në programet ekzistuese, në frymën e natyrës ndërdisiplinore. Për shembull, në Universitetin e Tiranës, përfaqësuesit e programe të Mësuesisë, Punës Sociale dhe Politikave Sociale, Shkencave Politike, dhe Psikologjisë kanë punuar së bashku për të 'integruar' njohuritë dhe aftësitë për të drejtat e njeriut në sa më shumë të jetë e mundur kurse, duke filluar nga këshillimi te menaxhimi i klasës, nga zgjidhja e konfliktit te legjislacioni në arsim. Sipas Universitetit të Sarajevës, bashkëpunimi ndërmjet departamenteve të ndryshme në konferenca, grupet kërkimore, apo bashkëpunimi me OJQ-të, shërbejnë për të kultivuar një kuptim më të qartë të natyrës ndërdisiplinore.



Partnerët në Universitetin e Novi Sadit ofrojnë një model të tretë. Ata kanë krijuar një program ndërdisiplinor dyvjeçar MSc (me 120 ECTS) për të Drejtat e Njeriut dhe Multikulturalizmin në të cilin studentët ballafaqohen me një shumëllojshmëri çështjesh vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Programi është projektuar posaçërisht të jetë tërheqës dhe i përshtatshëm për studentët nga fusha disiplinore të ndryshme, si dhe për studentët e Programit Master në Mësuesi. Gjithashtu Universiteti i Prishtinës ka forcuar më tej bazën ekzistuese ndërdisiplinore nëpërmjet krijimit të një programi MA për Studime Kulturore në Fakultetin e Filozofisë. Universiteti European i Tiranës ka propozuar një program MA për të Drejtat e Njeriut, Sigurinë dhe Qeverisjen si një bashkëpunim i disa departamenteve.

Megjithatë, natyra ndërdisiplinore sjell problemet e veta, siç është identifikuar edhe nga Universiteti i Sarajevës. Ka mangësi të shprehura qartë në njohuri dhe një pjesë e mirë e personelit (në veçanti ai i vjetër), me një formim më të ngurtë brenda disiplinave të veta nuk është pajisur plotësisht për t'u angazhuar në zbatimin e qasjeve ndërdisiplinore. Përtej kësaj, ekzistojnë ende moskuptime të mëdha në lidhje me *domethënie* e natyrës ndërdisiplinore (ose shumëdisiplinore). Për më tepër, edhe në qoftë se do të mund të arrihet një kuptim i përbashkët, aspekte të veçanta praktike të disa lëndëve nuk mund të përdoren dhe aq lehtë, për shembull nëse marrim rastin e metodologjisë së kërkimit.

Aty ku ka probleme ka edhe zgjidhje dhe Universiteti i Sarajevës na sugjeron disa të tilla. Nëse çështjet e të drejtave të njeriut do të lidheshin më ngushtë me kërkimin në këtë fushë, atëherë këto çështje do të do të mund të shqyrtoheshin më lehtësisht nga departamentet në një mënyrë ndërdisiplinore. Gjithashtu edhe mësimdhënia e metodave të kërkimit do të mund të përshtatej drejt qartësisht të parimeve dhe problemeve që mbart kërkimi në fushën e *të drejtave të njeriut*, për shembull, kur diskutohen çështje që lidhen më etikën e kërkimit dhe aksesin apo vlefshëminë e statistikave zyrtare. Ekzistojnë dhe një sërë qasjesh të tjera teorike (ku përmendet 'teoria e lojës', një aspekt i teorisë së zgjedhjes racionale, apo marksizmi, feminizmi, post modernizmi etj.) të cilat funksionojnë në disiplina të ndryshme të shkencave sociale dhe të cilat mund të zbatohen lehtësisht për çështjet e të drejtave të njeriut. Pra ideja e një baze të përbashkët, si teorike apo metodologjike, nuk është e papërfytyrueshme.

Pra 'problemi' i natyrës ndërdisiplinore në fund të fundit nuk është dhe aq i madh. Universiteti i Gotenburgut shprehet se është e vërtetë se pedagogët mund të mos kenë njohuritë e duhura për t'u marrë me qasje ndërdisiplinore por kjo nuk përbën problem derisa ka njerëz të tjerë të cilët mund të merren më këtë gjë, e në këtë mënyrë kjo lloj qasje mund të balancohet ashtu siç duhet. Në fakt mund të thuhet edhe ndonjë gjë për natyrën jashtë mode të qasjes shumëdisiplinore e cila i ndihmon studentët dhe lektorët për të identifikuar më mirë problemet që gjenden brenda natyrës *ndërdisiplinore*, (për shembull, në ç'mënyrë e konceptualizojnë dhe i japin përparësi disiplinat e ndryshme koncepteve si 'e vërteta').

Ka mundësi që praktika më e mirë për mësimdhënie në fushën e të drejtave të njeriut të mos ketë lidhje më natyrën ndërdisiplinore (apo shumëdisiplinore). 'Të Drejtat e Njeriut' mund të zhvillohet si disiplinë më vete. Një disiplinë kërkon një arsyetim dhe një bazë teorike që e përcakton atë, dhe është e mundur që ta gjejmë këtë në thirrjet e famshme të Markusit për një teori kritike të shoqërisë: se jeta e njeriut ia



vlen ose duhet të jetohet, dhe se ekzistojnë mundësitë për përmirësimin e saj. Detyra disiplinore e të Drejtave të Njeriut atëherë do të ishte ndjekja e këtij projekti, nga i cili natyrisht do të dalin perspektiva teorike të ndryshme të cilat do të tregojnë sesi duhet vepruar për ta bërë më mirë këtë gjë.³

Nga ana tjetër, praktika më e mirë mund të përdoret për të lënë mënjanë këto pozicione disiplinore të paqarta dhe shpesh kontradiktore, të cilat bartin bagazhin dhe perceptimet e tyre të ngushta në lidhje me lëndën, dhe e fillojnë mësimin e të drejtave të njeriut me pyetje të tilla si: Çfarë do të thotë ky kumtim, dhe pse na nevojitet e gjithë kjo? Universiteti i Roehamptonit tregon një histori interesante për një student i cili ishte një aktivist i përkushtuar i të drejtave të njeriut në vendin e tij në perëndim të Afrikës. Pasi ndoqi këtë lëndë hyrëse për të drejtat e njeriut, ai iu afrua lektorit, me mirënjohje, për t'i bërë me dije atij se lënda kishte arritur të hidhte poshtë çdo gjë që ai mendonte se dinte në lidhje me të drejtat e njeriut, duke e detyruar që të sfidonte çdo gjë të cilën ai besonte. Nuk ka provë më të mirë për të treguar mundësitë e edukimit për të drejtat e njeriut i cili, që në nivelin hyrës, i kapërcen kufijtë tradicionalë disiplinorë.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Të diskutosh të drejtat e njeriut vetëm nga pikëpamja e një discipline të veçantë nuk është plotësisht e dobishme. Megjithatë, natyra shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore nuk mund të jetë zgjidhja ideale, nëse me këtë kuptojmë të bëjmë një orë mësimi në këtë disiplinë dhe një orë tjetër në një disiplinë tjetër. Është më mirë që të gjendet një bazë e përbashkët, veçanërisht në nivelin hyrës, por kjo nuk është gjithmonë e lehtë për ta përfshirë brenda kufizimeve të kurrikulës. Gjithashtu nuk është e arsyeshme që lektorët të përfshijnë thjesht disa elemente të natyrës ndërdisiplinore. Në mënyrë që natyra ndërdisiplinore të ketë kuptim, përtej retorikës boshe, duhet që të mbështetet nga burime, përfshirë këtu edhe trajnimet, personelin shtesë, ose studimin e rasteve të qarta dhe të kuptueshme të cilat tejkalojnë kufijtë disiplinorë. Natyra ndërdisiplinore sfidon praktikën ortodokse në mësimdhënie dhe vlerësim, e për këtë arsye nuk mund të zbatohet në një nivel moduli, ose me një të lëvizur të shkopit magjik. Ajo kërkon planifikim më të strukturuar dhe një mbështetje ndëruniversitare.

PËRFSHIRJA E STUDENTËVE

Përfshirja e studentëve ndahet në dy lloje: kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare. Lehtësimi i përfshirjes së studentëve në kurrikulën formale domosdoshmërisht përkon me fusha të tjera të praktikës më të mirë të diskutuara në këtë raport, përfshirë këtu përmbajtjen, punësimin dhe aftësitë, vlerësimin, dhe partneritetet e jashtme. Angazhimi në përfshirjen e studentëve duhet të ndjekë kërkesat e vetë studentëve, jo vetëm në lidhje me përmbajtjen siç u diskutua më sipër, por në lidhje me tregun e punës. Kjo mund të bëhet në një sërë mënyrash, siç sugjerohet dhe nga Universiteti i Sarajevës, të cilat përfshijnë: 'punësimin në OJQ-të të ndryshme, mësimdhënien interaktive, studimin e rasteve, ushtrimet në klasës, konkurset ndër-rajonale (argumente ligjore), ndarjen e grupeve të mëdha në grupe të vogla' dhe përveç këtyre duhen përshtatur teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënit qasjeve të studentëve, të cilat mund të përfshijnë ekskursionet, përdorimin e teknologjisë së fundit, filmat dokumentarë, dhe madje edhe

³ Ky pozicion mbështetet në O'Byrne, D. (2003) *Human Rights: An Introduction* Harlow: Pearson



ato komikë! Në qendër të kësaj qëndron një sfidë më e gjerë pedagogjike: nxitja e studentëve që të lexojnë më shumë për të ngjallur interesin, vëzhgimi i mënyrës sesi lidhet drejtpërsëdrejti shkrimi i eseve me shqetësimet në fushën e të drejtave të njeriut, të menduarit më me largpamësi dhe dhe në mënyrë më konceptuale, dhe nxitja e aftësive për zgjidhjen e problemit dhe zhvillimi i aftësive të transferueshme në vend që të mësohen vetëm fakte. Natyrisht, me një numër të madh studentësh këto stilet të reja pedagogjike mund të jetë e vështirë të zbatohen. Por pavarësisht kësaj, studentët duhet të ndiejnë se e zotërojnë programin e tyre dhe duhet të nxiten që të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse. Përfaqësimi i studentëve është i rëndësishme në të gjitha kurset universitare, por në arsimin për të drejtat e njeriut duhet të jetë i ngulitur në strukturën bazë të programit mësimor.

Çdo përpjekje për të lehtësuar pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet ekstra - kurrikulare kërkon përfshirjen e Qendrës së Shërbimit të Studentëve të Universitetit dhe/ose të Këshillit Studentor. Edhe pse mbështetja e njësisë të tilla është jashtë kompetencave të këtij raporti dhe të këtij projekti, kufizimet e burimeve do të përbënin një pengesë në këtë drejtim. Për shembull, Universiteti Europian i Tiranës përmend nevojën e financimeve për të ndihmuar krijimin e mjediseve më të mira për studentët me vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara fizike.

Klubet dhe shoqëritë e studentëve përbëjnë gjithashtu një burim të paçmueshëm. Shoqata për të Drejtat e Njeriut në Roehampton u krijua fillimisht si një shoqatë e udhëhequr nga studentët me qëllim që të përfaqësonte interesat e studentëve të programit BA për të Drejtat e Njeriut. Këto interesa përfaqësoheshin përmes ofrimit të mbështetjes dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe akademike, nëpërmjet organizimit të veprimtarive sociale dhe pjesëmarrjes së studentëve në komitete të përshtatshme. Por shpejt kjo shoqëri i kaloi kufijtë e një klubi universitar dhe filloi të merrej me fushatat sensibilizuese si dhe me aktivitete të bazuara në programe të ndryshme. Në Universitetin Europian të Tiranës, klubet e studentëve kanë organizuar një sërë leksionesh, fushatash dhe tryezash të rrumbullakëta për tematikën e të drejtave të njeriut. Në Universitetin Marin Barleti, klubet e studentëve kanë ndihmuar të nxisin 'tolerancën mes studentëve' nëpërmjet angazhimit në 'veprimtari të ndryshme informative, kulturore e sociale që shërbejnë si një mundësi e shkëlqyer për të zgjeruar njohuritë e tyre në lidhje me kulturat e tjera, dhe për të hedhur poshtë stereotipat'. Në Prishtinë, grupet e leximit të studentëve ndihmojnë për të lehtësuar përfshirjen në çështje të tilla si të drejtat e njeriut, pakicat fetare dhe ndihmën humanitare. Gjithashtu Universiteti i Prishtinës ofron programe verore që mbulojnë çështjet e sipërpërmendura.

Disa partnerë kërkojnë që të ketë një balancim ndërmjet këtyre të dyjave. Universiteti i Gotenburgut ofron aktivitete që janë edhe 'kurrikulare' dhe 'ekstra- kurrikulare'. Një shembull është pjesëmarrja (vullnetare) e studentëve në konferencën vjetore kombëtare të të drejtave të njeriut, për të cilën ky universitet ofron një bursë të vogël për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe regjistrimit. Një tjetër veprimtari është udhëtimi studimor në Stokholm i drejtuar nga pedagogët (i cili gjithashtu është vullnetar, por si dhe shembulli i mëparshëm, rekomandohet që të kryhet). Gjatë këtij udhëtimi vizitohen shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare të cilat gjenden atje. Duket qartë që kjo përputhet me çështjet e partneriteteve të jashtme si dhe me punësimin, për të cilat do të flasim më poshtë.



Në çdo rast, një gjë duket qartë: studentët angazhohen më shumë në fushën e të drejtave të njeriut kur mendohet se kjo do t'i japë zgjidhje problemeve dhe kur ka të bëjë me shqetësime bashkëkohore, sesa kur kjo fushë paraqitet në terma absolutë. Kur i referohemi përfshirjes së studentëve udhëzimi i vetëm më i rëndësishëm është që kurrikula të jetë e përshtatshme.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Edukimi për të drejtat e njeriut duhet të përfshijë veprimtari shkollore dhe jashtëshkollore. Për këtë qëllim, mund të jetë i nevojshëm bashkëpunimi mes fakultetit dhe shoqatës ose këshillit të studentëve me qëllim aftësimin e shoqatës së studentëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të organizojë veprimtaritë e veta, përfshirë edhe organizimin e fushatave. Kjo është e rëndësishme sepse në thelb arsimit për të drejtat e njeriut ka të bëjë me integrimin e teorisë dhe praktikës. Por, në të njëjtën kohë, në kuadër të kurrikulës formale, arsimit për të drejtat e njeriut bie në kundërshtim të hapur me vetë qëllimin e tij në qoftë se paraqitet si një qasje nga 'lart-poshtë'. Pra, studentët duhet të jenë aktorë aktivë dhe pjesëmarrës në procesin e vendimmarrjes në lidhje me kurrikulën, dhe gjithashtu duhet krijuar një shoqatë aktive studentore që të garantojë se zëri i studentëve përfaqësohet në komitetet e përshtatshme. Kjo, sigurisht, duhet të zbatohet për të gjitha lëndët, por është veçanërisht e rëndësishme në rastin e EDNJ.

PUNËSIMI DHE AFTËSITË

Partnerët janë në mënyrë të qartë dhe të drejtë të prirur të theksojnë shkallën në të cilën kurset dhe programet që ata kanë zhvilluar ose janë duke zhvilluar adresojnë çështjet e punësimit të studentëve. Për shembull, pritet që të diplomuarit në MSc për të Drejtat e Njeriut dhe Multikulturalizmin në Novi Sad falë aftësive të zhvilluara në këtë program 'do të jenë në gjendje që të punojnë në administratën publike, arsim, media, organizata humanitare, korporata private dhe si konsulentë'. Universiteti i Sarajevës ka të njëjtin synim, pra që të diplomuarit e programeve për të drejtat e njeriut të pajisen me aftësitë e duhura për të kryer një spektër të gjerë të punësh, nga punët në OJQ - të dhe deri tek media apo kompani private.

Për disa partnerë, çështja e punësimit lidhet ngushtë me çështjen e burimeve. Universiteti i Tiranës, për shembull, shprehet për nevojën për të punuar me organizatat e shoqërisë civile dhe krijimin e mundësive për punësim ose praktikë në këto organizata në mënyrë që të rriten perspektivat për punësimin e studentëve në sektorin e OJQ-ve. Megjithatë, duhet patur kujdes, sepse sipas Universitetit Europian të Tiranës, 'praktikat nganjëherë nuk e përmbushin qëllimin e tyre të vërtetë pasi organizatat nuk e kanë vullnetin që t'i përfshijnë studentët në veprimtaritë e tyre të përditshme'. Universiteti i Gotenburgut gjithashtu këshillon të jemi të kujdesshëm nga një këndvështrim tjetër – duhet që punësimi të paktohet në atë mënyrë që të reflektojë aftësitë e dëshiruara nga punëdhënësit e qeverisë (për shembull, duke u përqendruar në departamentin përkatës administrativ që ka të bëjë me çështjet e të drejtave të njeriut), duke qënë se shumë të diplomuar në fushën e të drejtave të njeriut nuk duan të identifikohen me këto aftësi dhe nuk kanë dëshirë të ndjekin rrugë të tilla karriere të cilat mund t'i perceptojnë si të tilla që bien ndesh me angazhimin e tyre për të drejtat e njeriut.

Në çdo rast, mungesa e instrumenteve të besueshëm për vlerësimin e punësimit në këtë kontekst përbën një shqetësim. Universiteti Europian i Tiranës bën një rekomandim interesant në këtë drejtim: arsimimi



ose trajnimi për të drejtat e njeriut duhet lidhur me një fushë tjetër, më atë të sigurisë apo qeverisjes (shih më sipër për MA e propozuar nga UET-ja), në mënyrë që ai 'të jetë më i drejtuar nga profesioni' dhe që t'i jepet legjitimitet i dukshëm. Ky rekomandim na kthen mbrapa tek diskutimi për natyrën ndërdisiplinore dhe sfidat apo mundësitë e paraqitura prej saj.

Është, natyrisht, shumë e vështirë për të dhënë rekomandime për praktikat më të mira sa i përket punësimit përderisa problemet dhe dështimet vazhdojnë të ekzistojnë dhe në vetë tregun e punës. Universiteti i Beogradit rendit mungesën e vendeve të lira të punës dhe çështjen e nepotizmit si shembuj të këtyre problemeve. Në fakt, *pavarësisht kësaj*, Universiteti i Beogradit është përpjekur shumë që kurset për të drejtat e njeriut të mund të ofrojnë diçka pozitive edhe në rrethana të zymta, duke krijuar lidhje të ngushta me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare të përfshira në monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shkallë kombëtare. Ne do t'i rikthehemi kësaj çështjeje sërish.

Është edhe një çështje e fundit që duhet përmendur në lidhje me punësimin dhe aftësitë. Tregu i jashtëm i punës është jashtëzakonisht i ndryshueshëm dhe nuk ka Universitet që të mund të garantojë punësim pas diplomimit, dhe as nuk duhet ta bëjë këtë. Sipas Universitetit të Sarajevës, problemi është se 'ka shumë studentë dhe nuk ka garanci për të siguruar vende në tregun e punës' dhe madje 'as 5 % e studentëve më të mirë nuk mund të fillojnë një punë pas përfundimit të shkollës'. Më e mira që mund të arrihet, sipas Sarajevës, është 'zgjidhja e asaj që mund të bëhet'. Në nivel programi dhe moduli duhet synuar zhvillimi i aftësive të tilla si të menduarit kritik, ndërkohë që përgjegjësia për të siguruar këshilla karriere (p.sh. nëpër panairët e punës, organizimi i seminareve për shkrimin e CV-ve etj) duhet të bëhet në nivel universiteti. Pedagogët nuk duhet të ndihen të detyruar që të luajnë rolin e këshilltarëve të karrierës, e as që të ndihen nën presion për të krijuar një përmbajtje që i përshtatet kërkesave të tregut të punës. Në të vërtetë, çdo përpjekje për ta bërë këtë do të mohonte vetë parimet e të menduarit kritik dhe reflektimit në të cilat mbështetet arsimit për të drejtat e njeriut.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Arsimit për të Drejtat e Njeriut nuk është dhe nuk duhet të jetë profesional në kuptimin më të ngushtë të fjalës (më shumë, për shembull, sesa studimet për biznesin). Ai nuk ka të bëjë me trajnimin për një karrierë të caktuar, dhe nuk presupozon ngjitjen e shkallëve në një sistem të paracaktuar. Arsimit për të drejtat e njeriut duhet të përqendrohet në zhvillimin e aftësive të transferueshme dhe në veçanti të të menduarit kritik si dhe t'i japë të diplomuarve një mundësi të mirë për punësim.

VLERËSIMI

Universitetet tradicionale, në të gjitha lëndët e ofruara prej tyre kanë përdorur vazhdimisht disa forma të caktuara vlerësimi si provimet formale dhe esetë standarde. Megjithatë, vitet e fundit, kanë filluar të zbatohen forma të reja vlerësimi të cilat sfidojnë format tradicionale të vlerësimit. Theksi i vihet formave të vlerësimeve të cilat përqendrohen te studenti dhe që kërkojnë paraqitjen e aftësive të të menduarit



Praktikat më të mira në edukimin për të drejtat e njeriut

kritik dhe zgjidhjes së problemeve. Shembuj të këtyre vlerësimeve janë: puna në grup, kërkimi i bazuar në raste, prezantimet e studentëve dhe simulimi i seancave gjyqësore (për studentët që studiojnë drejtësi). Nëse praktika profesionale është pjesë e kurrikulës, atëherë është e nevojshme që ajo të vlerësohet bazuar në kritikën vetë-reflektuese të studentit, dhe nuk është e mjaftueshme që të tregohen vetëm aftësitë praktike apo orët e shpenzuara për të bërë një punë të 'vlefshme'.

Në mënyrë që arsimi për të drejtat e njeriut të jetë kuptimplotë atëherë duhen zbatuar këto risi, dhe nëse është e nevojshme, duhet sfiduar tradita në vlerësim. Universiteti i Tiranës është një nga shumë institucionet partnere që përdor vetëvlerësimin, vlerësimin e studentëve nga studentët, vlerësimin në grup, krahas metodave formale të vlerësimit. Parimi udhëheqës është që vlerësimi duhet t'i përgjigjet kërkesave të lëndës. Për shembull, në një lëndë që përqendrohet te shqetësimet reale për të drejtat e njeriut, nuk ka kuptim që studenti të vlerësohet nëpërmjet një provimi formal që nuk bën asgjë tjetër vetëm se vlerëson aftësinë e studentëve për të mbajtur mend fakte të caktuara.

Universiteti European i Tiranës është në favor të asaj që e quan 'qasja konstruktiviste me në qendër studentin' e cila ka të bëjë me:

...vlerësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive të studentëve në një lëndë të caktuar nëpërmjet eseve, provimeve, punës në grup dhe prezantimeve në klasë. Për më tepër organizohen në klasë debate apo diskutime për tema aktuale në kontekstin shqiptar. Studentët gjithashtu mund të zgjedhin studim rasti ose të punojnë për atë që i ka caktuar pedagogu.

Sipas Universitetit European të Tiranës dhe Universitetit të Sarajevës, ajo që mungon, është një nivel i krahasueshëm analize, për shembull, krahasimi ndërmjet përvojës së Bashkimit Evropian dhe asaj të Evropës Jug-Lindore, ose ndërmjet vendeve të rajonit.

Kjo përbën një problem dhe kërkon një zgjidhje. Një problem tjetër i dukshëm janë dhe format jostandarde të vlerësimit, si, prezantimet e studentëve (që ofrojnë një mundësi shumë të mirë për të zhvilluar disa aftësi), por janë të natyrës krejt praktike. Si mund të menaxhohet në mënyrën e duhur ky lloj vlerësimi brenda afateve të caktuara dhe duke pasur një numër shumë të madh studentësh në një klasë? Ndërsa disa partnerë përkrahin sistemet e vlerësimit të studentëve për njëri-tjetrin në grupe më të vogla, të tjerë mund të kenë rezerva për praktikitetin edhe të kësaj forme vlerësimi në grupe akoma më të mëdha ku zakonisht janë pedagogët përgjegjës për vlerësimin.

Në Universitetin e Roehamptonit, një formë e veçantë vlerësimi, specifike për lëndën e 'Sociologjisë dhe Antropologjisë së të Drejtave të Njeriut', është 'dosja për fushatën'. Ky është një aktivitet që bazohet tek puna në grup e katër ose pesë studentëve të cilët simulojnë krijimin e një OJQ-je të vogël për të drejtat e njeriut. Grupet nxiten që të mos jenë shumë ambiciozë (si organizata të vogla, ato duhet të kenë një qëllim të mirëpërcaktuar. Pra në vend që të krijojnë OJQ të mëdha që mbulojnë të gjitha problemet që lidhen me të drejtat e njeriut në botë, ata duhet të merren me një shqetësim vendor, për shembull, shfrytëzimi i fëmijëve ushtarë në një vend të caktuar). Më pas ata duhet të vendosin qëllimet specifike të tyre, për shembull, do punojnë për të çrrënjësuar problemin, apo ofrojnë edukim për të. Kjo përcakton dhe llojin e



OJQ-së që përfaqësojnë, pra OJQ që merret me arsimin, fushatat, mbledhjen e fondeve, lobimin, përkrahjen, rehabilitimin, këshillimin etj. Dokumenti që ato prodhojnë, dosja e fushatës, është një dosje që përfshin historinë, statistikën, politikat dhe studimin e rasteve etj. që lidhen me një çështje të caktuar, si dhe strategjinë e fushatës. Ata jo vetëm që e përgatisin dosjen për të marrë notën, por atyre u kërkohet të paraqesin dhe fushatën përpara klasës duke luajtur rolin e folësve të ftuar nga OJQ-ja të cilët përpiqen që t'ia mbushin mendjen të tjerëve që t'i bashkohen kauzës së tyre. Kjo formë e veçantë vlerësimi ka prodhuar vazhdimisht një punë të shkëlqyer, dhe kjo si rezultat i pasionit që kanë studentët për të prezantuar fushatën e tyre. Ky lloj vlerësimi është çmuar edhe nga vlerësuesit e jashtëm të cilët janë shprehur se puna e studentëve është po aq e mirë sa edhe puna e bërë në një OJQ të vërtetë dhe disa prej grupeve të studentëve janë gati që ta bëjnë këtë punë 'realisht'. E kam përmendur këtë shembull vlerësimi pasi ai është krijuar posaçërisht për të përmbushur kërkesat e lëndës. Gjithashtu ky lloj vlerësimi lehtëson zhvillimin e aftësive të transferueshme të nevojshme për punësim. Studentët e përfshirë në këtë lloj vlerësimi merren me kërkimin e fakteve dhe mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike për t'i gjetur zgjidhje problemeve.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Të gjitha format e vlerësimit duhet të drejtohen nga qëllimet dhe objektivat e vetë lëndës. Provimet formale apo esetë standarde mund të mos jenë të përshtatshme në të gjitha rastet (në disa raste ata mund të mos funksionojnë fare). Format e reja të vlerësimit në arsimin për të drejtat e njeriut duhet të përqendrohen te studenti dhe duhet të merren me çështjet aktuale duke i mundësuar studentëve gjetjen e zgjidhjeve për probleme të vërteta. Zbatimi i vetëvlerësimit, vlerësimi i studentit nga studentit apo vlerësimi në grup bën të mundur që studentët të pajisen me aftësi të vetëvlerësimit që u duhen për karrierën e ardhshme. Këto metoda do të ndihmojnë që të forcojnë procesin reflektiv të studentëve dhe të nxisin vetë-drejtimin në procesin e të nxënës.

BURIMET

Sipas disa raporteve, tri fusha kyçe që lidhen me burimet e një universiteti të cilat paraqesin sfida të mëdha dhe duhen parë me kujdes për të siguruar zhvillim e duhur të arsimit për të drejtat e njeriut janë: biblioteka (përfshirë këtu, abonimet në revistat online, si dhe revistat apo librat e zakonshëm); teknologjitë e informacionit dhe komunikimit të cilat mundësojnë një komunikim dhe shkëmbim më të shpejtë ndërmjet palëve të interesuara; dhe burimet njerëzore, pra stafi i përshtatshëm dhe i përkushtuar. Në shumicën e rasteve kontrolli i këtyre burimeve është jashtë ndikimit të çdo programi apo departamenti. Në kuadër të financimeve të gjithë departamentet dhe njësitë e ndryshme konkurrojnë për një numër të vogël burimesh. Atëherë kur këto të fundit nuk janë të disponueshme, shumë i drejtohen burimeve të financimit të jashtëm në mënyrë që të përfitojnë burime të posaçme të cilat administrohen në nivel vendor. Këto financime të jashtme përfitohen ose nëpërmjet departamenteve apo fakultetit ose nëpërmjet qendrave për të drejtat e njeriut. Sigurisht që këto financime të jashtme nuk janë dhe aq të lehta për t'u siguruar.



Burimet e posaçme në arsimin për të drejtat e njeriut ndryshojnë në varësi të partneritetit. Universiteti i Sarajevës dhe Universiteti i Prishtinës tashmë kanë qendra të posaçme në nivel universiteti për të drejtat e njeriut. Në Universitetin e Roehamptonin vepron një qendër kërkimore për të drejtat e njeriut e mbështetur nga universiteti e cila quhet Crucible dhe që dikur njihej me emërtimin Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie dhe të Nxënë dhe financohej nga qeveria. Tashmë kjo qendër shërben për të nxitur kërkimet dhe për të mbështetur partneritetet e jashtme dhe konsulencën në fushën e të drejtave të njeriut dhe gjithashtu shërben si një 'shtëpi' intelektuale për studentët e MA dhe për studentët e tjerë që merren me kërkime në këtë fushë. Në disa institucione partnere, qendra të tilla ekzistojnë në nivel fakulteti. Në Universitetin e Beogradit, për shembull, Fakulteti i Shkencave Politike ka një qendër për 'Të drejtat e Njeriut dhe Organizatat Ndërkombëtare' e cila shquhet në veçanti në fushën e të drejtës humanitare, dhe çdo vit organizon shkollën rajonale për të drejtën humanitare, duke mbledhur disa nga studiuesit dhe studentët më të mirë nga rajoni. Universiteti i Prishtinës gjithashtu ka lokalizuar qendrat kërkimore në Departamentin e Shkencave Politike dhe në Fakultetin e Filozofisë të cilat mund të lehtësojnë punën për të drejtat e njeriut. QDNJ në Prishtinë është veçanërisht e rëndësishme si një rast për krijimin e praktikës më të mirë. Pak vetë do të ishin kundër krijimit të qendrave të posaçme për organizimin e aktiviteteve në çdo fushë akademike pasi ato janë të dobishme për lulëzimin e veprimtarisë në atë fushë, dhe do të ndihmonin në përqendrimin e burimeve. Janë pikërisht këto qendra për të drejtat e njeriut që mundësojnë konsulencat, programet e trajnimit dhe seminarët e ndryshme (p.sh. për gazetarë, studiues, juristë). Në këtë mënyrë krijohen dhe lidhjet me OJQ-të, nisin kërkimet e ndryshme dhe formohet biblioteka e një cilësie të lartë e të drejtave të njeriut (shumica e institucioneve të tjera kanë burime të posaçme për të drejtat e njeriut në bibliotekën kryesore të Universitetit). Veprimtaritë e organizuara përmes QDNJ janë pikërisht llojet e veprimtarive që aspirojnë të ndërmarrin shumë universitete që kanë një angazhim për të zhvilluar edukimin për të drejtat e njeriut:

Objektivat kryesore të Qendrës janë të kontribuojë për të drejtat e njeriut, të nxisë studimin e të drejtave të njeriut dhe të mbështesë çështjen e të drejtave të njeriut në rajon. Për të arritur këto qëllime Qendra promovon dhe kryen veprimtari kërkimore në fushën e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ofron shërbime këshillimore për institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare për çështjet e të drejtave të njeriut. Ajo nxit dhe është e angazhuar në veprimtari kërkimore për të drejtat e njeriut, në mësimdhënie në fushën e të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet arsimore. Qendra për të Drejtat e Njeriut organizon kurse dhe forma të tjera të trajnimit në fushën e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunon me qendra të ngjashme, institucione, organizata qeveritare dhe joqeveritare dhe organet e tjera të të drejtave të njeriut.

Universiteti i Sarajevës, Universiteti i Prishtinës, dhe Universiteti i Roehamptonin, në tërësi ose pjesërisht përmes Qendrave të tyre përkatëse, organizojnë festivale të filmit për të drejtat e njeriut. Në Roehampton, ky i është bashkëngjitur një moduli të quajtur 'Të Drejtat e Njeriut në Film' i cili i nxit studentët jo vetëm ta shikojnë filmin si një mënyrë për promovimin e interesimit për të drejtat e njeriut, por edhe si një mënyrë për të zhvilluar aftësitë në bërjen e filmave. Kjo ka lejuar krijimin e lidhjeve të afërta me pedagogët dhe studentët në fushën e filmit dhe medias.



Megjithatë, siç u tha më lart, një nga sfidat kryesore me të cilat përballen akademikët që dëshirojnë të themelojnë qendra të tilla është sigurimi i financimeve të jashtme (duke pasur parasysh kërkesën e lartë për financim nga universitetet, dhe përparësinë që i jepet shkencës, teknologjisë, biznesit në klimën e tanishme ekonomike si dhe faktin që politikat nuk i favorizojnë shumë kërkesat për mbështetje për edukimin për të drejtat e njeriut). Projektet e veçanta siç janë festivalet e filmit shpesh kërkojnë një sasi të konsiderueshme investimesh. QDNJ në Prishtinë ka marrë fonde nga Ministria e Jashtme e Austrisë (nëpërmjet lidhjeve të saj me Shërbimin Botëror Universitar të Austrisë), nga Komisioni Evropian, nga Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut i Ministrisë së Jashtme të Finlandës, si dhe nga donatorë individualë. Financimi i burimeve përbën një çështje që mund të adresohet drejtpërdrejt përmes projektit Tempus HEART dhe ndarjes së fondeve, të cilat mund të përdoren për të ndihmuar në rritjen e cilësisë dhe disponueshmërisë së këtyre burimeve edhe për partnerë të cilët tashmë kanë themeluar një Qendër të tillë.

Së fundi, për sa i përket burimeve në përgjithësi, një nga pengesat kryesore me të cilën përballen shumë partnerë është mungesa e disponueshmërisë së burimeve në gjuhën vendore. Shumica e burimeve tradicionale publikohen ose prodhohen në gjuhën angleze, gjë që përbën problem për personat që nuk dinë anglisht. Përkthimet nga ana tjetër nuk janë gjithmonë lehtësisht të disponueshme dhe kanë koston e tyre. Për këtë arsye financimi për përkthimet është kthyer në një përparësi.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Shumica e universiteteve, departamenteve dhe kurseve kanë kapur një treg të brendshëm të financimeve të centralizuara. Në klimën e tanishme ekonomike dhe të politikave, ka të ngjarë që arsimit për të drejtat e njeriut të mos shihet si një përparësi, duke e bërë të domosdoshme që departamentet të kërkojnë ndihmën e financimeve të jashtme për të themeluar Qendrën e tyre të Drejtave të Njeriut. Ata të cilët dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë mund të mësojnë shumë nga përvoja e atyre partnerëve të cilët tashmë e kanë themeluar një Qendër të tillë. Megjithatë, ç'është më e rëndësishmja, burimet kryesore duhet të jenë në dispozicion në gjuhën angleze dhe në gjuhën vendore.

PARTNERITETET E JASHTME

Shumë partnerë të projektit përfitojnë nga marrëdhënie afatgjata me organizatat e shoqërisë civile - një shembull është lidhja afatgjatë e Universitetit të Zenicës me CIVITAS. Universiteti i Beogradit ka krijuar lidhje të ngushta me një sërë organizatash kombëtare të të drejtave të njeriut dhe e sheh këtë si thelbësore në ndjekjen e praktikave më të mira në zhvillimin e punësimit të studentëve:

Bashkëpunimi ka dy aspekte. Studentët tanë gjejnë vendin për të bërë praktikën/apo gjejnë vendin e punës në këto organizata, ndërsa shumë nga studentët tanë të MA janë tashmë anëtarë të këtyre organizatave dhe ndjekin leksionet për të rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre. Ne veçanërisht bashkëpunojmë me OJQ-të më të njohura për të drejtat e njeriut në Serbi (Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut).



Universiteti i Beogradit përmend Qendrën e Beogradit në këtë deklaratë, por kjo nuk është organizata e vetme me të cilën bashkëpunon, pasi Fakulteti i Shkencave Politike gjithashtu mban marrëdhënie të mira me organizatat e tilla si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Zyra e Avokatit të Popullit, dhe Komisioneri për Informata të Rëndësishme Publike dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Duke mbështetur përvojën e Univeristetit të Beogradit, partnerët nga Universiteti i Tiranës kanë theksuar rëndësinë e krijimit të një bashkëpunimi më të ngushtë midis Universitetit dhe shoqërisë civile, pasi këto organizata shërbejnë si një burim i shkëlqyer, veçanërisht në lidhje me mundësinë për të siguruar vendin e praktikës për studentët të cilët nëpërmjet tyre mund të mësojnë më shumë gjëra rreth çështjeve për të drejtat e njeriut në Shqipëri. Kjo është një pikëpamje që mbështetet më tej nga partnerët e Universitetit të Prishtinës të cilët u vjen keq për mungesën e bashkëpunimit midis institucioneve akademike dhe joakademike me organizatat si vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Kjo pikëpamje mbështetet edhe nga Universiteti European i Tiranës i cili si sfidë kryesore shikon disponueshmërinë e studimeve, raporteve dhe dokumentave të prodhuara nga aktorë të tjerë që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, siç janë organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë qeveritare. Organizatat e tilla gjithashtu prodhojnë raporte të cilat mund të jenë të dobishme për mësimdhënien. Sipas raportit të Universitetit të Tiranës:

Organizatat e shoqërisë civile kanë një ekspertizë të pasur në trajtimin e të drejtave të njeriut si në aspektin teorik ashtu edhe praktik. Ato janë një thesar i shoqërisë sonë që duhet të përdoret. CRCA, Komiteti i Helsinkit, etj janë vetëm disa nga këto organizata

Disa partnerë i përdorin mirë lidhjet që kanë me OJQ-të në fusha të tjera të përafërta të universitetit. Për shembull, Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës ka përfunduar një projekt pesëvjeçar i quajtur 'Identiteti i humbur' i drejtuar në bashkëpunim me OJQ-të që punojnë në sektorin e arteve, qëllimi i së cilit ishte krijimi i perspektiva të reja kritike dhe krijuese në institucionet artistike dhe praktikën e ndryshme. Duket theksuar fakti se kur flasim për partneritetet me OJQ-të, nuk bëhet fjalë vetëm për ato OJQ që punojnë *drejtpërdrejt* në sektorin e të drejtave të njeriut (p.sh. fushata ose grupet e mbështetjes). Siç e kemi diskutuar tashmë, të drejtat e njeriut i kapërcejnë të gjithë kufijtë disiplinorë dhe mund të trajtohen nga një sërë perspektivash. Zhvillimi i një lënde për të drejtat e njeriut përmes, le të themi, letërsisë apo kinemasë do të ishte e vlefshme dhe kontribut i vlefshëm në edukimin për të drejtat e njeriut. Po ashtu edhe krijimi i lidhjeve me agjencitë e jashtme në sektorin kulturor do të mundësonte rritjen e përvojës së studentëve në fushën e të drejtave të njeriut. Si një shembull i kësaj, partnerët në Prishtinë i referohen lidhjeve me Dokufest, një OJQ përgjegjëse për prodhimin e filmave dokumentarë, dhe organizimin e festivaleve të filmit, në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut. Këto filma apo dokumentarë mund të përdoren në shkollat e mesme për të edukuar nxënësit për tema të rëndësishme si varfëria, racizmi dhe të drejtat e fëmijëve. Këtu, OJQ-ja shërben si një burim në vetvete (dmth. si një mënyrë për të angazhuar studentët e universitetit në çështjet e të drejtave të njeriut nëpërmjet bashkëpunimit) dhe si një burim *për të gjeneruar burime të tjera* (p.sh. dokumentarët që mund të shfaqen në shkolla, që më pas domosdoshmërisht kërkon përfshirjen dhe bashkëpunimin me pedagogët e Departamentit të Edukimit të Universitetit).



Megjithatë, krijimi i lidhjeve me OJQ-të e përshtatshme nuk është gjithmonë e lehtë për institucionet akademike. OJQ-të më të vogla janë të zëna me çështje që kanë të bëjnë me shqetësimet e tyre dhe nuk mund të kenë kohë për të krijuar partneritete të tilla, edhe në qoftë se ato kanë dëshirë për ta bërë një gjë të tillë. Disa mund të pyesin me të drejtë: Çfarë përfitojmë nga kjo? Nga këndvështrimi i Universitetit, Departamentit ose Qendrës, përfitimi është i qartë: praktika për studentët, të ftuarit, shfrytëzimin e raporteve dhe burimeve arsimore. Për OJQ-të përfitimet nga një partneriteti i tillë nuk janë dhe aq të qarta. Si mundet që krijimi i lidhjeve me institucionet akademike të ndihmojë drejtëpërsëdrejti një OJQ në fushatën e saj? Universitetet, për shembull, mund të sigurojnë hapësirën apo burimet për të ndihmuar dhe lehtësuar punën e OJQ-ve, dhe këtë mund ta bëjnë nëpërmjet këshillimeve në lidhje me të dhënat teorike apo konceptuale në raportet e OJQ-ve të cilat mbështesin dhe kontekstualizojnë aktivitetet e fushatës së OJQ-ve. Kur krijohen lidhje të drejtëpërdrejta me OJQ-të, akademikët duhet të jenë të vetëdijshëm se partneritetet duhet të jenë reciprokë dhe të dobishëm për të dyja palët. Akademikët gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se OJQ-të disa herë kanë një vizion mjaft të ngushtë në lidhje me atë që përbën të drejtat e njeriut, dhe perspektivat e tyre mund të kundërshtojnë atë që u diskutua më lart në lidhje me praktikën më të mirë për përmbajtjen dhe përfshirjen e studentëve. Akademikët duhet të bëjnë kujdes të mos i përfshijnë OJQ-të në programe pa një sens kritik.

Partneritetet e drejtëpërdrejta natyrisht që nuk duhet të krijohen për t'u mundësuar universiteteve përdorimin e burimeve ekzistuese të OJQ-ve siç janë botimet. Siç është theksuar në raportin e Tiranës, dhe është përsëritur nga Sarajeva, OJQ-të vendore si dhe ato ndërkombëtare priren që të bëjnë raporte që përmbajnë statistika të dobishme, raste studimore etj, të cilat mundësojnë angazhimin e studentëve në çështje kyçe. Filmat mund të jenë gjithashtu një burim i dobishëm. Përveç kësaj, përdorimi i burimeve vendore të ofruara nga OJQ-të ndihmojnë për të kapërcyer atë që shumë e quajnë si një pengesë kryesore në edukimin për të drejtat e njeriut: pra, se pjesa më e madhe e literaturës ekzistuese është në gjuhën angleze, gjë që paraqet një pengesë për studentët, siç thuhet dhe në raportin e Universitetit European të Tiranës.

Vëmendja kryesisht është përqëndruar tek partneriteti me OJQ-të, por është gjithashtu e rëndësishme që të përfshihen në partneritet edhe agjencitë qeveritare. Megjithatë, autonomia është e rëndësishme për shkak se integriteti intelektual (dhe moral) rrjedh prej saj, dhe, siç u theksua nga Universiteti i Gotenburgut, shumë studentë e bëjnë dallimin mes punës së kryer nga OJQ-të për të drejtat e njeriut dhe punës së kryer nga agjencitë qeveritare në fushën e të drejtave të njeriut. Në të dy rastet, studentët duhet ta shohin nga një këndvështrim *kritik* dhe nuk duhet të marrin si të mirëqenë që puna e bërë nga OJQ-ja është e vlefshme sepse ajo po bën një 'punë të mirë'. Në të vërtetë, është më e lehtë për një student (ose një akademik) që të kritikojë (në kuptimin akademik të fjalës) punën e një agjencie qeveritare sesa punën e një OJQ-je, por të gjitha këto partneritete duhet të menaxhohen me kujdes.

STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile siç janë OJQ-të janë bazë e qenësishme për edukimin për të drejtat e njeriut, i cila nuk duhet bërë vetëm për të përfituar klasa apo bibliotekën, për leksionin dhe për librin, por edhe për të diskutuar problemet dhe për t'i gjetur zgjidhje atyre. Në mënyrë që partneriteti të funksionojë efektivisht, duhet të konceptohet si një kontratë e dyanshme. Gjithashtu, përfshirja e OJQ-ve në ofrimin e

edukimit për të drejtat e njeriut duhet të shikohet me një sens kritik, dhe të mos merret si një e mirë absolute. Ai duhet të përshtatet me kontekstin e programit mësimor. Për më tepër, partneriteti me agjencitë qeveritare mund të jetë i dobishëm në disa raste, por duhet trajtuar me kujdes .

KËRKIMI

Marrëdhënia mes mësimdhënies dhe kërkimit është vendimtare për rolin e çdo universiteti. Shpesh këto të dyja shihen si pa lidhje, dhe ndonjëherë dhe sikur kanë kërkesa krejt të kundërta me njëra-tjetrën. Në disa universitete në Mbretërinë e Bashkuar ekziston një ndarje e padobishme ndërmjet personelit që merret me 'kërkimin aktiv' dhe atij që 'zbritet' vetëm në rolin e 'mësimdhënies' e shkatur nga auditimet e qeverisë në kuadrin e Kornizës së Ekselencës në Kërkim. Në disa raste kjo ndarje është pasqyruar në të gjithë sektorin, duke bërë dallimin mes universitetve të kërkimit dhe atyre të mësimdhënies.

Por në fakt nuk është kështu. Mësimdhënia gjithmonë do të përfitojë nga përfshirja e personelit të kërkimit aktiv, të cilët janë në krye të diskutimeve në fushën e tyre, duke botuar artikuj në revista dhe duke marrë pjesë në konferenca, dhe të cilët do të përfshijnë në leksione debatet më të reja. Por nga ana tjetër edhe kërkimi përfiton nga mësimdhënia: shumë ide vijnë gjatë orës së mësimi dhe gjatë diskutimeve me studentët ose gjatë përgatitjes së materialeve për një leksion.

Shumica e partnerëve të përfshirë në këtë projekt përkrahin kërkimin, ashtu siç përkrahin risitë në mësimdhënie dhe të nxënë. Për shembull, në raportin e tij të detajuar, Universiteti Europian i Tiranës, rendit një sërë projektesh kërkimore për të cilat po punon personeli i tij. Shumë prej këtyre projekteve kryhen nëpërmjet qendrave të tij kërkimore. Personeli është përfshirë gjithashtu në mbikëqyrjen e studentëve të përfshirë në kërkime të ndryshme. Siç ndodh me shumicën e institucioneve, ata që janë përfshirë në këto projekte dhe mbikëqyrje i njohin vështirësitë me të cilat përballen, të cilat përfshijnë kryesisht vështirësitë financiare si gjetja e organeve të përshtatshme të financimit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë. Vështirësi gjithashtu përbën edhe bërja e këtyre projekteve publike, për shembull promovimi i këtyre veprimtarive kërkimore tek publiku i gjerë.

Nuk mund të vihet në dyshim rëndësia që kanë shumë prej këtyre projekteve kërkimore për zhvillimin e kurrikulës së arsimit për të drejtat e njeriut, dhe përfitimet që sjellin për aktorë të ndryshëm - studentët, universitetin, dhe komunitetin, siç thuhet nga Universiteti i Kragujevacit. Le të marrim disa shembuj: Universiteti Europian i Tiranës ka kryer një projekt për fëmijët e rrugës në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoni dhe Kosovë; gjithashtu në UET, është ndërmarrë një projekt doktoral i financuar për demokracinë dhe përfshirjen e komunitetit rom; në Universitetin e Prishtinës është kryer një projekt kërkimor mbi rolin e shoqërisë civile në Kosovë, dhe një tjetër për zbatimin e EDNJ-së në Kosovë. Përfitimi duket qartë. Këto projekte kanë ndikuar drejtëpërsëdrejti në zhvillimin e kurrikulave përkatëse në arsimin për të drejtat e njeriut. Njësoj si me çështjen e partneriteteve të jashtme në sektorin e OJQ-ve, kjo çështje lidhet me thelbin e projektit të arsimit për të drejtat e njeriut. Pra arsimit nuk mund dhe nuk duhet të kufizohet brenda mureve të klasës. Ka praktika të cilat provojnë se edukimi për të drejtat e njeriut



zhvillohet brenda një kornize që mbështet veprimtarinë kërkimore, megjithëse kufizimet e burimeve e pengojnë ndonjëherë këtë mundësi.

STANDARDE TË PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Arsimi për të drejtat e njeriut duhet të ecë në një hap me kërkimin në fushën e të drejtave të njeriut, pasi të dy janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Kjo gjë duhet marrë parasysh kur bëhet ndarja e burimeve duke iu referuar një qasjeje bashkërenduese në nivel universiteti.

PËRVOJA E TRASHËGUESHME

Çfarë përvoje të trashëgueshme përfitojnë programet apo institucionet që janë pjesë e partneritetit nga zbatimi i arsimit për të drejtat e njeriut? Në shumë raste, planifikimi strategjik afatgjatë në këtë fushë nuk është marrë parasysh. Për shembull, Universiteti i Prishtinës identifikon mungesën e një plani afatgjatë të bazuar në vlerësimin e praktikave institucionale, dhe sugjeron se 'një mekanizëm i tillë mund të ndihmojë njësitë dhe departamentet për të vlerësuar suksesin, arritjet dhe boshllëqet e veprimtarive aktuale, dhe për të mundësuar planifikimin e duhur për praktikatat e ardhshme'. Raporti nga Universiteti Marin Barleti, megjithatë, vlerëson haptazi angazhimin e këtij institucioni në fushën e të drejtave të njeriut, aq sa ai ka 'miratuar një sërë nismash që synojnë për të promovuar të drejtat e njeriut', duke përfshirë bursa sociale për studentët me prejardhje të caktuara ekonomike, kulturore dhe sociale. Flitet shumë se kjo 'pjesëmarrje në zgjerim' (siç quhet në Mbretërinë e Bashkuar) është me rëndësi të madhe për të gjithë arsimin e lartë në tërësi, dhe për mësimdhënien në edukimin për të drejtat e njeriut në veçanti.

Ndoshta mënyra më e mirë për të trajtuar çështjen e përvojës është duke marrë parasysh kapacitetet transformuese të edukimit për të drejtat e njeriut. Kjo mund të arrihet të paktën në katër mënyra:


- (i) Transformimi i studentëve: Duke përhapur një përvojë arsimore që nuk është vetëm kuptimplotë, por që sjell dhe një përfitim të mirëpritur ndaj idesë se universiteti është një hapësirë në të cilën i jepet rëndësi dhe arrihet arsimi politik, arsimi për qytetarinë globale, çështjet aktuale;
- (ii) Transformimi i pedagogëve: Duke sfiduar ortodoksinë pedagogjike dhe mendjengushtësinë disiplinore dhe krijimi i mundësive të reja disiplinore për vetë pedagogët në mënyrë që të luajnë rol të vlefshëm në një projekt kuptimplotë dhe afatgjatë;
- (iii) Transformimi i kurrikulave dhe vetë universitetit: Duke ndërprerë kufijtë disiplinorë dhe duke futur në universitet ndjenjën e përkushtimit ndaj qëllimit transformues dhe shoqëror që ka arsimi përtej qëllimit parësor që ka ai pra të shpërndarjes së njohurive ose siç i quan Habermasi, 'njohurive teknikisht të dobishme', ndoshta edhe duke e nxitur universitetin që të angazhohet në fushën e të drejtave të njeriut (siç ndodhi me Universitetin e Roehamptonit pas krijimit të Crucible), ose duke treguar angazhimin e tij në fushën e të drejtave të njeriut në ndonjë mënyrë tjetër të drejtpërdrejtë, të ngjashme me rastin e Univeristetit Marin Barleti të përmendur dhe më lart;



- (iv) Transformimi i shoqërisë: Duke ndikuar mbi politikën dhe mendimet publike dhe politike, duke bërë dallimin si nëpërmjet njohurive të prodhuara në mësimdhënie dhe kërkim ashtu edhe nëpërmjet edukimit të brezit të ardhshëm të liderve .

Dhe ndoshta, përveç këtyre, është e rëndësishme të theksohet se arsimit për të drejtat e njeriut duhet të transformohet vetë, nëpërmjet aftësive të tij transformuese të renditura më lart, si dhe nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm. Nëse edukimi për të drejtat e njeriut në vetvete bëhet dogmatik, ai humbet të gjithë fuqinë e tij transformuese.

Si përfundim, sa u tha më lart përmbledhet në mënyrë perfekte nga një version i modifikuar i një diagrami të paraqitur nga Universiteti i Kragujevacit:



STANDARDE PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË: Arsimi për të drejtat e njeriut duhet, mbi të gjitha, të ketë një rëndësi shoqërore, duhet të jetë kritik ndaj ortodoksisë, duhet të sfidojë strukturat e pushtetit, dhe duhet të nxitet nga aftësitë e tij transformuese. Ai duhet të jetë i *transformueshëm*. Ai nuk mund

të jetë thjesht një tjetër dogmë. Ai duhet t'i përgjigjet transformimeve që mundëson dhe kushteve në të cilat ndodhin këto transformime.

PËRMBLEDHJE

Fushat kryesore	Përmbledhje e rekomandimeve për praktikën më të mirë
Përmbajtja	Duhet të jetë e hapur për një sërë interpretimesh të konceptit 'të drejtat e njeriut', nuk duhet të kufizohet tek disa përkufizime të veçanta
Natyra ndërdisiplinore	Duhet të bazohet te diskutimet për sfondin e përbashkët ndërmjet disiplinave sesa të pranojë vetëm pluralizmin intelektual
Përfshirja e studentëve	Duhet të përqendrohet te studenti, duhet të jetë demokratike, dhe të fillojë nga 'poshtë-lartë'. Kërkon përfshirjen e veprimtarive ekstra-kurrikulare, të drejtuara nga studentët si dhe veprimtari formale kurrikulare
Punësimi dhe aftësitë	Duhet të përqendrohet tek aftësitë e transferueshme dhe të menduarit kritik sesa të jetë thejst profesional dhe i drejtuar nga tregu
Vlerësimi	Duhet të drejtohet nga qëllimet dhe objektivat e lëndës sesa të drejtohet nga tradita dhe duhet të përfshijë aftësi të reja të zgjidhjes së problemeve
Burimet	Idealisht duhet përqëndruar te qendrat e dedikuara të burimeve dhe kur është e mundur te qendrat përkatëse vendore dhe që mundësojnë qasje
Parnetritetet e jashtme	Rëndësi kanë lidhjet me OJQ-të dhe shoqërinë civile, por partneriteti duhet të sjellë përfitime reciproke
Kërkimi	Duhet të ndërlihet me mësimdhënien, nuk duhet të ballafaqohet me të apo të trajtohet në mënyrë holistike
Përvoja e trashëgueshme	Duhet të jetë transformuese për studentët, pedagogët, kurrikulën, universitetin dhe shoqërinë

©Dr Darren O'Byrne, 1.3.13

Të dhëna nga:

Universiteti European i Tiranës (Shqipëri)

Universiteti Marin Barleti (Shqipëri)

Universiteti i Tiranës (Shqipëri)

Universiteti i Sarajevës (Bosnje Herzegovina)

Universiteti i Zenicës (Bosnje Herzegovina)



Praktikat më të mira në edukimin për të drejtat e njeriut



Universiteti i Prishtinës (Kosovë)

Universiteti i Beogradit (Serbi)

Universiteti i Kragujevacit (Serbi)

Universiteti i Novi Sadit (Serbi)

Universiteti i Roehamptonit (Mbretëria e Bashkuar)

Universiteti i Gotenburgut (Suedi)



Co-funded by the
Tempus Programme
of the European Union